



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

RELACION TEKNIK

(KONTRATA NR.13)

Mirembajtje me performance rruga: "**Fierzë-B.Curri (Varrezat e Dëshmorve), B.Curri - Cërrnicë, D/Sopot-Kam, Dushaj - Sheshi i trageteve - Lekbibaj**"

Përshkrim i përgjithshëm.

Aksi rrugor "Fierze – B.Curri (Varrezat e Dëshmorve) " (14.8 km), është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetin Bajram Curri me njesit administrative Bujan , Fierze si dhe rrethin e Tropojes me Tiranen. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me bankina 2x75 cm te paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Akset rrugore " B.Curri - Cerrnicë" (3.2) km dhe "D/Sopot- Kam " (27.7) km jane segmente rrugore pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Keto segmente rrugore është pjesë e aksit kryesor që lidhë qytetin B.Curri me Hasin. Segmenti klasifikohet i kategorisë F si rrugë lokale , me një karrexhatë, me nje korsi levizje me nje sens me dy bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 4 m. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**Dushaj – Sheshi i trageteve - Lekbibaj " (14.1 km) është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër i shtuar me VKM Nr.600. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh njesin administrative Dushaj me njesin administrative Lekbibaj. Segmenti klasifikohet i kategorisë C interurbane dytësore dhe F si rrugë lokale me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), nga Dushaj deri tek Sheshi i trageteve në Km. 3, ndersa nga Sheshi i trageteve ne Lekbibaj me nje sens levizje.me bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml per pjesen e patre ndersa 4 m per pjesen e dyte. Për nga shtrirja**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	B.Curri (Varrezat e deshmoreve)- Fierzë	14.8	42°20'58.3"	20°04'57.4"	42°15'21.9"	20°01'58.6"
2	Bajram Curri - Cërnicë	3.2	42°21'26.4"	20°05'19.2"	42°21'45.4"	20°06'38.8"
3	D/Sopot - Kam	27.7	42°22'16.9"	20°07'08.6"	42°14'56.8"	20°13'09.5"
4	Dushaj - Sheshi i Trageteve - Lekbibaj	14.1	42°16'49.5"	20°01'34.1"	42°17'39.8"	19°55'54.7"
Shuma (km):		59.8				

Kushtet e inspektimit.

Sot me datë 28.03.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore **"Fierzë-B.Curri (Varrezat e Dëshmorve), B.Curri - Cërnicë, D/Sopot-Kam, Dushaj - Sheshi i trageteve - Lekbibaj"**. Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përlllogaritjen e fondit limit, si objektiv i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029), me qëllim hartimin e preventivave për përlllogaritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .

Gjëndja e akseve rrugore **"Fierzë-B.Curri (Varrezat e Dëshmorve), B.Curri - Cërnicë, D/Sopot-Kam, Dushaj - Sheshi i trageteve - Lekbibaj"** është mesatare në përgjithësi me disa problematika që vijnë edhe si pasojë degradimit të disa elemnteve rrugorë që favorizohen nga relievi i vështirë malor dhe nga kushtet ekstreme atmosferike. Ruget kane disa shëmbje të mureve mbajtës e pritës dhe disa çedime në trupin e saj. Edhe shtresat asfaltike kanë filluar pjesërisht të amortizohen, ku me amortizim edhe gjatë 4- 5 viteve të ardhshme do të linte nevoja për realizimin e riveshjeve pjesore. Duhet menjëhere pas lidhjes së kontratës së mirëmbajtjes të kryhen disa punime rehabilitimi në mënyrë që rruget të sillen në një standart të pranueshëm për qarkullimin e mjeteve, dhe gjatë zbatimit të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

kontratës së ardhshme të realizohen punime rehabilituese periodike për ta mbajtur në kushte të duhura teknike për qarkullimin e mjeteve.

Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.

● Segmenti rrugor “Fierze – B.Curri“ (14.8 km), është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare, por në disa km. ky segment rrugor ka nevojë të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme, vendosjen e mbrojtëseve metalike të zëvendësojmë me të reja. Duke para vërshimit e koheve të fundit është menduar realizimi i dy tombinave Ø 800 në km 11 dhe 12. Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin në disa zona të kunetave anësore me bordurë, pasi ka shumë zona ku ato mungojnë, duke sjellë si pasojë vërshimin e ujërave brinjë buzës së asfaltit dhe duke u bërë shkak për dëmtimin e tij. Në dy vende në km 16 dhe km 4 është menduar ndërtimi i kanaleve anësore me beton për largimin e ujrave, gjithashtu është menduar edhe përmirësimi i vizimit në këtë segment rrugor. Segmenti rrugor “Fierze – B.Curri“ (14.8 km) është një segment që shtrihet në një terren malor dhe me mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo pusetave të tombinave. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkëqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpit, është menduar ndërtimi i kunetave me bordurë, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabelat. Gjithashtu është menduar dhe ndërhyrja në disa pozicione të favorshme për rrëshqitje, ndërhyrja do të bëhet me anë të zërit “Rrafshim skarpate”. Në kilometrin 9 kemi evidentuar shëmbjen e një muri pritës guri në një gjatësi rreth 11 m. Në këtë gjatësi parashikojmë të ndërtojmë një mur guri të ri. Gjithashtu një mur butobetoni mbajtës me gjatësi rreth 50 m është parashikuar edhe në km 13 për të rehabilituar një çëdim të trupit të rrugës. Përveç këtyre punimeve që përmendëm më lart janë përcaktuar edhe punime të tjera më të vogla të shpërndara pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së aksit me qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe përgatitjen në avancë për situatat e mundshme





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

problematike që mund të shfaqen gjatë katër viteve të ardhshme. Gjithashtu meqenëse në këtë segment rrugor ndodhen edhe një numër i madh muresh prej guri të vjetër, janë menduar edhe disa ndërhyrje në riparimin e tyre.. Një pjesë të këtyre problematikave kemi menduar ti zgjidhim duke parashikuar ndërtimin e brezave të ri. Duke parë rreshqitjen e gurve dhe inerteve nga skarpatat në disa vende kemi menduar për veshjen e tyre me rrjete. Megjithatë ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevojën që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

Volumet e punimeve të tjera janë paraqitur të fragmentarizuara në segmente prej 1km në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

- Segmenti rrugor " **B.Curri – Cernice -Kam** " (30.9),km. është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjendje mesatare, por në disa km. ky segment rrugor ka nevojën të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme, vendosjen e mbrojtësive metalike të zëvendësojmë me të reja. Duke parë vërshimet e koheve të fundit është menduar ndërimi i dy tombinave Ø 800mm në Ø 800mm në km 12 dhe 17 Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin në disa zona të kuletave anësore me bordurë, pasi ka shumë zona ku ato mungojnë, duke sjellë si pasojë vërshimin e ujërave brinjë buzës së asfaltit dhe duke u bërë shkak për dëmtimin e tij. Në km 1 është menduar ndërimi i kanalit anësor me beton për largimin e ujërave, gjithashtu është menduar edhe përmirësimi i vizimit kryesisht në qendrat e banuara. Segmenti rrugor i përbërë " B.Curri – Cernice -Kam " (30.9) km. është një segment që shtrihet në një terren malor dhe me mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo pusëve të tombinave. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqësimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

ndërtimi i kunetave me bordure, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela. Gjithashtu është menduar dhe ndërhyrja në disa pozicione të favorshme për rrëshqitje, ndërhyrja do të bëhet me anë të zërit “Rrafshim skarpate”. Përveç këtyre punimeve që përmendëm më lart janë përcaktuar edhe punime të tjera më të vogla të shpërndara pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së aksit me qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe përgatitjen në avancë për situatat e mundshme problematike që mund të shfaqen gjatë katër viteve të ardhshme. Gjithashtu meqenëse në këtë segment rrugor ndodhen edhe një numër i madh muresh prej guri të vjetër, janë menduar edhe disa ndërhyrje në riparimin e tyre. Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

Në lidhje me vijëzimet, rezulton se pjesa më e madhe e aksit është në gjendje relativisht të mirë dhe është menduar që ai të ribëhet kryesisht në zonën e qendrës të banuar për të rritur sigurinë në rrugë. Standarti i përdorur masivisht për rrugët e kategorisë F për vijëzime është : 2 vijat me trashësi 15cm. Të njëjtin standart kemi ndjekur edhe në parashikimin e vijëzimeve që do realizohen katër vitet e ardhshme. Vijëzimet janë llogaritur nëpër zonat të banuara, nëpër shkollat apo institucionet dhe nëpër pjesët e rrugës që do të nënshtrohen riveshjeve. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuara në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

● Segmenti rrugor "**Dushaj - Sheshi i trageteve - Lekbibaj " 15 km.** është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Një problematikë që vlen të përmendet është shemja e skarpatave të herë pas herëshme duke bërë në shumë raste bllokimin për disa orë të këtij aksi, përveç kësaj është dhe renja e eprditshme e gureve si rezultat i terrenit malorë. Nga vëzhgimi jonë na rezulton se në disa vende ka cedime të trupit të rrugës. Janë të domosdoshme vendosja e mrojtësive metalike të reja në km13 dhe 14.

Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjendje mesatare, por në disa km. ky segment rrugor ka nevojë të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme, vendosjen e mbrojtësive metalike të zëvendësojmë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

me të reja. Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin në disa zona të kunetave anesore me bordurë, pasi ka shume zona ku ato mungojnë, duke sjellë si pasojë vërshimin e ujërave brinjë buzës së asfaltit dhe duke u bërë shkak për dëmtimin e tij. Ne nje vende ne km 8 eshte menduar ndertimi i kanalev ansore me beton per largimin e ujrave,gjithashtu eshte menduar edhe permirsimi i vizimit ne te gjith segmentin. Segmenti rrugor " Dushaj - Sheshi i trageteve - Lekbibaj "14.1 km është një segment që shtrihet në një terren malor dhe me mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo pusetave të tombinove. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja te dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar ndërtimi i kunetave me bordure, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela. Gjithashtu është menduar dhe ndërhyrja në disa pozicione të favorshme për rrëshqitje, ndërhyrja do të bëhet me anë të zërit "Rrafshim skarpace". Përveç këtyre punimeve që përmendëm më lart janë përcaktuar edhe punime te tjera më të vogla të shpërndara pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së aksit me qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe përgatitjen në avancë për situatat e mundshme problematike që mund të shfaqen gjatë katër viteve të ardhshme. Një pjesë të këtyre problematikave kemi menduar ti zgjidhim duke parashikuar ndërtimin e parapeteve të reja dhe brezave te ri. Duke pare rreshqitjen e gurve dhe inerteve nga skarpatat ne disa vende kemi menduar per veshjen e tyre me rrjete. Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kami evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasi të këtyre punimeve ti paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente pej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet me te lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave te rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit periodike.

Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :

Nr.Ana	Përshkrimi i punimit	Njesia	Sasia
	1. PUNIME GERMIMI		
3.119/a	Germim shkëmbi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkëmb, në themele gjëresi ~2 m, me shkarkim në toke,	m3	2460
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , në kanale gjëresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në toke	m3	1345
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	1145
3.161/2	Rrafshim skarpate në germim, ekskavator 0.25m ³	m2	6550
	2. PUNIME SHITRESASH		
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	5870
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	260
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	2320
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	2680
3.969	Skarifim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	8140
3.164/1a	Mbushje me material të germuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri	m3	344
	3. ANALIZA TEKNIKE		
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	5870
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	11480



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

	4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE		
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	1273
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	887
	5. PUNIME HEKUR BETONI 3		
3. 287	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing 6 ~ 10mm	ton	1.1
3. 288	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing > 12mm	ton	2.5
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3	415
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	335
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	405
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	400
3. 366	Tombino me tuba betoni \varnothing 800, mbi shtrese betoni	ml	40
	7. PUNIME TE NDRYSHME		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	370
	8. D. SINJALET DHE PAJSJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	8
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	31300
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	18
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	35
	11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	46



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	28
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	24
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	8
3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	220
3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	45
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	40
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	35
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	546
3. 165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	12

Foto nga inspektimi në terren.

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Më poshtë fotot e realizuara në terren :

GRUPI I PUNËS :

